



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 11.02.2015, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen shumëpalëshe ndërmjet vendeve të Evropës Juglindore, për zbatimin e konventës “Për vlerësimin e ndikimit mjedisor në kontekst ndërkufitar”.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Oerd Bylykbashi, Armando Subashi, Vasilika Hysi, Bashkim Fino, Pandeli Majko, Blendi Klosi, DashamirPeza, Ulsi Manja, Vexhi Muçmataj, Tom Doshi, Petrit Vasili, SilvaCaka, Eduart Halimi, Arben Ristani, Gent Strazimiri, Mhill Fufi, Fatmir Mediu, Tahir Muhedini, Nard Ndoka.

Të ftuar:

Redi Baduni - drejtor në Drejtorinë e Mjedisit.

Florinda Avdullai - juriste në ministrinë e Mjedisit

Fatmir Xhafaj - ... Ne rend dite kemi projektligjin “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen shumëpalëshe, ndërmjet vendeve të Evropës Juglindore, për zbatimin e konventës "Për vlerësimin e ndikimit mjedisor në kontekst ndërkufitar”.

Relatore është zonja Caka. Nga Ministria e Mjedisit të pranishëm për të paraqitur dhe mbrojtur projektin janë:

Redi Baduni, drejtor në Drejtorinë e Mjedisit.

Florinda Avdullai, juriste.

Fillimisht nga Ministria e Mjedisit një paraqitje, një ekspozitë të shkurtër të projektit dhe në vazhdim nëse ka ndonjë gjë nga kolegët.

Redi Baduni – Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Projektligji që ne po ju paraqesim sot ka për qëllim aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen shumëpalëshe ndërmjet vendeve të Evropës Juglindore për zbatimin e konventës “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis ndërkufitar”. Konventa ka për qëllim vlerësimin e ndikimit në mjedis të projekteve që zhvillohen në zonat ndërkufitare dhe mendohet se mund të ketë ndikim në mjedis në vendet fqinje.

Shqipëria është bërë palë e kësaj konvente më 4 tetor të vitit 1991, ku synohet bashkëpunimi midis shteteve për mbrojtjen e mjedisit ndërkufitar nga projektet me ndikim në mjedis.

Gjithashtu qëllim tjetër i këtij projektligji është që të sigurojë çështjet mjedisore përfshirë dhe ato shëndetësore, ku të merren për bazë dhe në konsideratë nga zhvilluesit e planeve dhe programeve të zhvillimit ekonomik social. Konventa ka disa amendime të cilat janë pasqyruar dhe në projektligjin aktual. Gjithashtu nga konventa e ESPO-s është kërkuar nëpërmjet pikës sonë të Fokalit që kemi atje, të bëhet ratifikimi i kësaj marrëveshjeje shumëpalëshe midis vendeve të Evropës Juglindore dhe palës shqiptare.

Ju bëj me dije se pjesëmarrja në këtë konventë dhe miratimi i këtij ligji nuk ka efekte financiare, sepse burimet njerëzore ndodhen aktualisht në Ministrinë e Mjedisit.

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

Besoj se është e qartë dhe nga teksti i marrëveshjes, por edhe nga paraqitja që bënë përfaqësuesit e Ministrisë së Mjedisit. Kush ka pyetje? Relatorja e ka shpërndarë materialin.

Silva Caka – Zotëria i përmendi të gjitha. Unë thjesht do të doja të theksoja ndoshta që konventa synon bashkëpunimin midis shteteve për mbrojtjen e mjedisit ndërkufitar nga projektet me ndikim në mjedis nëpërmjet njoftimit paraprak të shtetit, mjedis i cili mund të ndikohet nga një projekt i caktuar. Njoftimi bëhet nga shteti që synon të zbatojë projektin në territorin e shtetit që përmenda, i cili e fton shtetin, që mund të ndikohet, të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të ndikimit në mjedis të projektit të propozuar. Njëkohësisht duke njoftuar shtetin e ndikuar për vendimin përfundimtar për projektin dhe kushtet që duhet të respektohen për mbrojtjen e mjedisit. Në aspektin ligjor dhe procedural projektligji është konform Kushtetutës dhe Rregullores së Kuvendit.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj - Faleminderit, zonja Caka!

Pyetje nuk ka. Ka ndonjë koment? Po, zoti Mediu.

Fatmir Mediu – Konventa e ESPO-s është shumë e rëndësishme që ka të bëjë me projekte të cilat kanë ndikim në mjedis, në shtetet ndërkufitare, por ka dhe të përcaktuara disa elemente të detyrueshme për shtetet përkatëse para se të marrin investime të caktuara të cilat ndikojnë në vendet ndërkufitare. Dua të tërheq vëmendjen në dy çështje të cilat duhet t'i gjykojmë të rëndësishme. Njëra ka të bëjë me pretendimin për ndërtimin e një hidrocentrali në pjesën e Maqedonisë, ku pjesës maqedonase duhet t'i kërkohej me insistim që të paraqesë vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe efektet që do të ketë për shkak të investimit, ashtu siç janë dhe investime në zonën detare nga ana e palës greke. Pra, do të ishte mirë që këto marrëveshje, sidomos marrëdhënie të tilla të kenë dhe elemente detyruese, në mënyrë që të mos ngelen thjesht si marrëveshje në një koncept të gjerë, por të ketë elemente, të cilat patjetër vendosin detyrim si për palën shqiptare, por dhe për palët e tjera për t'iu nënshtruar një gjykimi të përbashkët. Ndodh shpesh që ne përpiqemi të japim të gjithë vlerësimin tonë, gjykimet tona për sa u përket këtyre

projekteve, që mund të kenë ndikim në vendet fqinje, por ka qëndrime joreciproke, do të thosha, nga vendet e tjera në raport me këtë çështje.

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

Ka komente të tjera? Nuk ka.

Kush është dakord në parim me projektligjin? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në parim.

Kush është dakord me nenin 1? Dakord.

Kush është dakord me nenin 2? Dakord.

Kush është dakord në tërësi me projektligjin? Dakord.

Miratohet.

Faleminderit!

Faleminderit përfaqësuesve të Ministrisë së Mjedisit!

Ditën e hënë në orën 10:00 do të jetë seanca dëgjimore me grupet e interesit për ndryshimet në ligjin “Për qeverisjen vendore”. Seanca dëgjimore do të jetë me Nënkomisionin për Qeverisjen Vendore. Pra, do të drejtohet nga zoti Fino si kryetar i këtij Nënkomisioni. Natyrisht, deputetët do të jenë të pranishëm për të bërë pyetje në këtë seancë dëgjimore.

Faleminderit!

Seanca mbyllet.

MBLEDHJA MBYLLET